

VASIL TABAKU



HYRJA E PRAFQERES




814-1
T12

VASIL TABAKU

HYRJA E PRANVERËS

poczi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

HYRJA E PRANVERËS

Nga gëmusha e bleruar
u ngrit zogu dhe nga krahët dimrin shkundi.
Marsi, me mijëra manushaqe, tokën puthi.
Me një lirikë
pranverën putha edhe unë.

Gëzuash, pranverë! ...
Afshi yt është në çeljen e luleshqerrës,
në bisqet e grurit e sythet e pemës,
në frymëmarrjen e blerimit është ...
Edhe në receptorin ku telefonon kjo vajzë
adresën time të largët veriore
edhe në kopshtin e këtyre fëmijëve,
që emrin tënd përsërisin brenda një vjershe
edhe në dashurinë e ushtarit,
që në jakën e kapotës
mban të çelur një burbuqe.
Afshi yt është kudo, stinë ripërtëritëse,
në gjithë qenien e bleruar të Atdheut.

POEZIA E NËNËS

Retë dridhen lehtë përmbi hënë,
ashtu si shamia jote dridhet përmbi thinja.
Paske dalë t'më presësh,
paske dalë, moj e mira nënë,
me njérën dorë nga gëzimi
harruar te zemra ...

Paske dalë,-
buza ç't'u dridhka prej mallit...
Ç'mendon ashtu, moj e mirë,
ç'mendon? ...
Mos vallë ditët e dhembjes së largët,
ditët kur tim at' prisje,
tim at' me yll, pushkë e flamur
dhe të prunë atëherë vetëm një këmishë
grisur nga plumbat nëpër luftë ...

Si rrezja fijen e njomë të barit
më rrite.

Ngrohtësia jote
m'u bë dashuria ime e pamort,
puthjet e tua — shëndeti dhe forca ime,
qumështi yt
m'u bë gjaku im...

Rritu, më the,
rritmu, bir, për Partinë!
T'më bëhesh për nuse,
t'më bëhesh për pushkë, kazmë dhe këngë...
Rritmu...

Dhe ika larg, nënë,
ika nëpër atdhe
gjersa ta shtova kaq shumë mallin.
Ika,
e pak nga pak mbi supe
ndjeva peshën që rritej të socializmit.

Ika fëmijë
e kthej komunist, moj nënë,
i fortë e i ndershëm
si gjaku i tim eti
dhe gjaku i patharë i gjithë të rënëve.

Dhe ja, ti paske dalë.
Buza s'e mban dot gazin,
psherëtimën e mallit, jo ...

FËMIJËRIA

Macja që loz me lëmshin e kaltër të mbesës
nuk shthur thjeshtë atë lëmsh,
kujtimet e mia zgjidh,
fijet e jetës
 shpleks lehtë-lehtë,
ditët e para të fëmijërisë ...

Ditët e para të rritjes,
këmbët vrarë nga gurët,
këmisha e zbardhur varur në gardh,
festa e abetares,
rrepa dhe gjyshi i bardhë,
një këngë e posamësuar për Partinë
tëk fluturonte nëpër gjithë kopshtin,
një pushkë druri sipër tavolinës,
me dy inicialet e gdhendura të emrit tim,
dhe një flamur i vogël
në duart e mia.

U rritém kaq shpejt...
po fëmijëria më duket sikur
zgjuar,
gjithë zëra, prapa derës është
e më thotë: «U rrite: pa shih, je bërë burrë!»

Loz macja
loz edhe mbesa ime,
ngadalë lëmshin e kaltër mbledhin,
ngadalë sikur druhën
mos fëmijërinë time trembin.

DY FJALË PËR BABANË

Punëtor si gjithë punëtorët-im at,
naftëtar i vjetër
me thembrat e çizmeve ngrënë
rrugëve të palodhshme
sondë më sondë,
naftën duke mbledhur në grushte
me ngazëllimin e një gëzimi të brendshëm
që i buron nga dy cepat e rrudhur të syve.

Duart e tij të mëdha
ngjyrën e naftës ruajnë nëpër pore e të çara...
Era e naftës për të
ka diçka të veçantë,
të dashur
ashtu si aroma e grurit për bujkun ka.

Ai vjen nga rruga e gjatë e viteve
me supet e shtruar nga puna.

Midis flokëve, si zambak i bardhë,
i harliset një tufë thinjash të reja...

Ndiej dorën e tij mbi supe
dhe gjithë duart e qëndrueshme të shokëve ndiej,
kundërblllokadën
në formën e mijëra duarve
që mijëra tonelatë naftë
si gjak në dejet e industrisë derdhin.

DESHA TË THOSHA DIÇKA

Unë desha të thosha diçka
ndërsa dëgjoja kërcitjen e druve që digjeshin
përmes të qeshurave hokatare të shokëve.
Desha të thosha diçka
tek shikoja përmbi supin e shokut, tej në horizont,
si thërrmohej kjo natë janari
në pritjen e lindjes së përditshme të diellit,
që asnijëherë s'na u duk e përsëritshme,
asnijëherë e ngjashme me lindjen e djeshme.

Unë desha të thosha diçka
për bukën e montatorëve, që sapo lanë turnin,
tek theket mbi sobë,
për aromën e saj të ëmbël
dhe duart e mëdha që e ndajnë më katërsh.

Për këtë natë montimi,
për krahët e ëndrrave montatore,
që rrahin paprerë drejt lartësive të pesëvjeçarëve,

për tetëmbëdhjetëvjeçarin Ylli,
që ngjitet sot për herë të parë në lartësi,
për kantierin që pret i zgjuar mëngjesin,
për ditën e sotme-
unë desha të thosha diçka.

Ballsh 1974.

D J E R S A

Mbi këmishën e betonistit,
midis dy shpatullave të gjera,
pashë djersën të hapej në trajtën e një trëndafili...

E kur betonisti
kokën ngre dhe me shpinën e dorës
ballin fshin
në mendimet e tij hedh valle Ballshi.
Oxhakët e pambaruar — mbarojnë, nxjerrin tym.
Trenat ngarkuar me naftë
kalojnë tejpërtej buzëqeshjes së tij.

Sot Ballshi dhe kjo ditë e kaltër
hedhin paprerë mbi ballin e betonistit
tufa lulesh stërpikur me bulëza djerse,
me rrënjet thellë në heroizmin e pabujshëm të këtij
mëngjesi
që betonohet në themelet e kësaj vepre.

Ballsh 1974.

KUR U DASHURUA NJË SHOK

Eshtë fillimi i pranverës
dhe shoku im i çiltër vjen çdo mëngjes në kantier
me emrin e një vajze në buzë
që aftron aq shumë me emrin e një luleje.

Ai vjen më i freskët përmes rrugëve...
Në dy sytë e tij çelin dy gonxhe buzëqeshjce,
në supet e gjerë rrinë dy krahët e vajzës
që i japid forcë
 betonin të ngjeshë më shumë.
Në gjoksin e djersitur fryn flladi i flokëve të saj...
Ajo vajzë,
si papritur,
 u bë mikja jonë më e shtrenjtë.
Dhe kur të vijë vjeshta me fletën e martesës,
ne dhuratën
 me fjongan e inaugurimit do t'ia lidhim.
Do t'i sjellim shokut tonë
 prodhimin e parë të uzinës,
se dashuria e tyre filloi kur ne themelet ngrinim.

Ballsh 1974.

NË VEND TË EPILOGUT

Ndërtuesit janë në ikje,
po çmontojnë skelat,
dhe skodat me dërrasat gjithë llaç
rendin drejt kantiereve më të rinj të atdheut.

Punonjësit e rruga-urës shtrojnë metrat e fundit me
ASFALT,
elektriçistët

montojnë në shtylla llampat.

Në mendimet e të gjithëve
valavitet shiriti i kuq i inaugurimit,
përshëndetjet e sirenave të para,
qielli mbushur me fishekzare,
rrugë me buzëqeshje,
sheshe me duartrokitje.

Naftëtarët, veshur me kostumin e festave
hyjnë në valle.

Kjo ditë
hyn në pavdekësinë e këngëve...

URË E QABESE

Urë e largët në lindje,
urë me gurë të mëdhenj nxirë si muzgje,
me shpinën shekullore kërrusur nga pesha e mijëra
ushtrive

tek dyndeshin drejt orientit,
mbytur në zheg e pluhur,
duke mbartur mbi vete
tragjedinë e madhe të moskthimit.

Bir' i Shqipërisë
kaloi mbi ty dhe mbi ty treti rininë,
nën flamuj e klithma të huaja,
poshtë qiellit zhuritës të Saharës së vdekjes
për të mos u kthyer më kurrë viseve të dashura.

Urë e Qabesë,
si hyre kështu në këngët tona,
në pikën e lotit të nënave,
në ëndrrat e vajzave,

në dridhjen e buzëve që thaheshin
ndërsa në krahët e grave
mbetej emri i nizamit pa varr
dhe ofshama e një mallëkimi për flamujt e huaj
që rrëmbyen bijtë larg në rrugën e moskthimit.


Urë e Qabesë,
kënga jote
këndohej si himn i dhembjes
nën çatitë prej kashte rrënuar nga pritja.
O, mallëkuar qofshin gjithë luftrat pa fund të sullta-
nëve!

Ushtari i varrosur atje larg
kish lënë një këngë,
një këngë që dënonte luftrat grabitqare të globit:
«Mbeçë, ore shokë, mbeçë
përtej urës së Qabesë...»
Ndërsa dielli i lindjes perëndonte i madh, tepër i kuq,
ngarkuar me tragjeditë më të mëdha të kohës.

Tani, moj urë e zezë,
mbi shpinën tënde gjithë gunga, ngrënë nga ikja,
si deve e gjyntuar në shkretëtirë,
nuk ngrihen më re pluhuri nga këmbët dhe arabatë.
Ti mbete e varrosur në këngët e dhembjes
ngritur mbi lumenjtë e gjakut të mijëra ushtrive,
por arkitektura jote e shëmtuar
rishfaqet nga shekulli në shekull në imagjinatën e ko-
mbeve.

Harku i thyer i shpinës sate,
mbi këmbë grataçielash,
mbart përsëri ushtritë agresore
të sulltanëve të rinj të botës.

Dhe Shqipëria ime
do ta këndojë këngën tënde hedhur mbi iso,
do ta këndojë
gjersa sulltani i fundit i kapitalit të japë shpirt.



V L O R A

Baladë

Ecnin, ecnin ata trima,
në luftë drejt jugut shkonin
edhe këngën: «Vlora... Vlora...»
ndeziur epope këndonin.

Ndeziur epope këndonte
edhe trimi gunëbardhë, —
si ortek zemërimi zbriste
të rreptët male rradhë-rradhë.

Zbriste malet rradhë-rradhë,
në ballë puthja seç i digjte,
puthje e vajzës atje larg
si e dashurisë lulëkuqe.

«Vlora... Vlora... Vlor' e rrallë...»
Ç'janë gjithë këta dasmorë,

me flamerin ç'po ndodh vallë,
deti ç'ka që nxin, moj Vlorë?

Oh, nxin deti me dushmanë,
mbushur plot me gjëmime;
në vend të luleve plagë:
seç u skuq pranvera ime.

Tufa lulesh mbi të rënët,
një zambak plag' e Selamit;
gunën lart çonin erërat,
rënë mbi telat e dushmanit.

Rënë mbi telat e dushmanit
heshtte zemër e djaloshit,
pushkë e nxeh të rënë poshtë shkëmbit
me vështrimin përtej detit.

Me vështrimin lart mbi det
u përkul një çast dielli, —
«Vlora... Vlora...», çeli buzët
dhe pastaj përgjithmonë fjeti.

Fjeti trimi përgjithmonë,
atje larg e priste vajza
me një grusht të bukur ëndrrash,
me një grusht ëndrrash të bardha.

Po veç shiu mengadalë
vinte tej nga perëndimi
e pikonte shkëmb e mal
lot' të paprerë hidhërimi.

Dhe bashkë me emrin e trimit
stuhi erdhi vetë kënga,
u ngrit mbi shiun e hidhërimit,
zjarr gjëmoi: «Vlora... Vlora...»

VALLJA E TRIMËRISË

Kur i thanë Hankos, nënës së njërit prej trimave të Rrapo Hekalit, se djali i saj ra në mal, ajo hoqi shaminë nga koka dhe nisi një valle që sot në Mallakastër e quajnë «Vallja e trimërisë».

Hankua ish e lehtë si gjethi në valle,
vajzat pas këngës i venin rradhë-rradhë;
belin e hijshëm këputnin mengadalë,
herë ndezur flakë dhe herë ashtu shtruar.

Dhe çelnin këngë nga gjoksi i saj
e zemrat e vajzave çelnin për trimat,
që plot dashuri t'ua jepnin pastaj
djemve të fshatit si vetëtimat.

Një ditë Hankua stuhi doli në valle
e degët e çelura tundën rreptë pemët,
nga gonxhet pikonte gjaku ngjyrë alle
dhe zi të dridhshme mbanin këngët.

Tej në male komiti kishte rënë,
pas një istikami kish heshtur një pushkë.
Një çezmë gjaku derdhej mbi shkëmb
e flamuri i kombit bëhej më i kuq.

Nga koka e hoqi të bardhën shami
dhe i ranë mbi supe flokët e djegur,
mbi dhembjen e të gjithëve u ngrit si stuhi
në vallen fisnikë nga shoqet e ndjekur.

PESHKATARI I THINJUR I LIQENIT TË SHKODRËS

Kështu do ta mendoj gjithmonë atë;
me cigaren e dredhur trashë në buzë,
me dy duar të mëdha gjithë luspa peshku
dhe dy sytë
si dy liqene të vegjël të pagjumë.

Kështu do t'më kujtohet gjithmonë peshkatari i vjetër,
që me ujin e dallgët u mësua,
ashtu
si ne me tokën u mësuam gjithë jetën.
Ai në shpirt
ka diçka nga qetësia fisnike e liqenit,
diçka nga kthjellësia —
 në mendim,
diçka nga kumbimi i dallgëve —
 në fjalë,

diçka nga ledhatimi i valëve —

në pëllëmbën e gjerë
tek kalon dorën mbi kokën e nipave.

Kështu do ta kujtoj peshkatarin e thinjur
me një cigare të trashë
e dy fjalë të mira në buzë...

K A R R O C I E R È T

I kam parë tek u grahin kuajve
ashtu fort:

— Iha, iha!

Me flokët nëpër gishtat e fortë të erës
dhe bishtin e njomur të cigares
harruar në buzën e poshtme
si një fjalë e ngrohtë që nuk u tha.

Në vend të kamxhikut
ngrehin zërin ata,
që më të butë, më njerëzore
e bën thirrjen e tyre
— Iha, iha!

Kam ndenjur me ta në një karrocë,
kam shkëmbyer fjalë,
kam shkëmbyer duhan.
Dhe s'them gjë të re, kur them se karrocierët,
si të gjithë njerëzit e ndershëm,
i japin socializmit.

ATË MBRËMJE NËNTORI

Po kthehesha atë mbrëmje me mbesën në krahë.
Çuçurimat e saj,
si fluturza, më gëlonin në gushë.
— Ua, xhaxhi!... Sa shumë xixëllonja
po fluturojnë sonte në rrugë!...

Eh, mbeskë, moj mbeskë!
E ku ka, moj xhan, xixëllonja në vjeshtë...
Kraharori i atdheut merr frymë me dhembje,
tërmeti këto ditë
na preku në juglindje.

Është vargu i kamionave që rend, moj mbesë,
s'janë xixëllonjat.
Ajo këngë që ngrihet mbi krahët e erërave,
këngë e vullnetarëve është,
këngë që ngrihet mbi tërmete.

FËMIJËT E VEPRËS SË RE

Nga erdhën kështu këta fëmijë
si tufa zogjsh cicëritës,
nga ç'stinë,
 nga ç'dashuri
bregut të Drinit në luginën gjëmonjëse të dritës?

Në krahët e nënave punëtore,
e shpenguar
si stërkalat rrezëllitëse të ujvarës,
shkërmçoqet e qeshura fëminore.

Në digë përkulen mbi ujëra
si kërcej të njomë trëndafilash
me faqet petale të përskuqura
puthur nga veriu, puthur nga drita.

Rrugët e porsahapura të veprës
ndiejnë hapin tepër të lehtë,

fëminorin hap
që nesër
gjurmë burrërore do të lërë.

Nga erdhën kështu këta fëmijë,
nga ç'stinë,
 nga ç'dashuri?
Pyeteni njërin prej tyre:
Ballshi e lindi,
Fierza po e rrit
burrërinë
veprave të ardhshme do ta marri.

DRITA E DRINIT

Një grusht ujë nga rrjedha e Drinit
nëpër gishtat e mi rrjedh
me mijëra rrezëllime...

Në kaltërsinë e rrëmbyer të këtij lumi
historia e ashpër e maleve rrođhi
ngarkuar me net mundimi
dhe rapsodi që i këndonin diellit
se populli im i stërlashtë,
me jetën tretur luftrave,
dritën
një si barutin e bukën deshi.

Dhe ne që për lirinë derdhëm gjak
e djersën
në sofrën tonë kthyem në bukë,
për dritën

zemrën tonë vumë turbinë.
Kaskadat e kaltra të ditëve do të derdhen...
Të rrahurat brenda gjoksit tonë,
dallgët e Drinit
dhe çdo pikë djerse
do të shndërrohet në dritë..

RAPSODI I DRITËS

Sot,
kur mbi rrugë
borë e bardhë vallëzonte
dhe erërat
loznin me pishat veriore,
betonisti Frrok
këndoi rapsodinë më të re të dritës.

Në gropën e çiftelisë
m'u bë sikur u përplasën dallgët e Drinit
e sytë e betonistit
u bënë shkëlqenjës...

Në fjalët e tij me akcent verior
kish vend për gjithë shokët,
kish vend për gjithë ditët dhe netët heroike...
Në fjalët e tij të ngrohta
kish vend për çastet e devijimit të Drinit
dhe për çastin e madh të dritës.

5 MAJ

Muaji i të rënëve
hyri në pragun e pranverës.
Në kopshtin e Shtëpisë së Partisë
trëndafilat e kuq çelën...

Në duart e fëmijëve
një tufë e përflakur lulekuqesh.

Në mermerin e varreve të dëshmorëve
një rreze dielli
dridhet si një fjongo purpurore
që lidh gjithë buqetat e mallit tonë...

INVALIDI I LUFTËS

Ne të gjithë lëmë nga dy gjurmë kur ecim
dhe mbresën e zakonshme te njerëzit lëmë,
ndërsa ky njeri lë vetëm një gjurmë të thellë
dhe dy gropë patericash që plotësojnë një këmbë.

Mbresa e tij tek ne është e fortë, shumë e fortë, —
hapi i vetëm i një kënge në rrugë.

E veten pyesim: Ku e la një këmbë ky njeri i thjeshtë?
Dhe padashur mendimet na rendin në luftë...

Na ushton gjatë çakçaku i hapit me një këpucë...
Ky njeri peshën e trupit dhe jetën i mbajti mbi një këmbë,
këmba e këtij njeriu të fortë kurrë s'u përkul,
i palodhur ndjek hapin tonë gjer në fund.

NISJA E USHTARËVE TË RINJ

Po shkojmë!

Diçka duam të themi,
diçka duam të dëgjojmë,
po, në vend të fjalëve, buzëqeshim.

Mbi supe

rri dora e baballarëve,
e rëndë si pesha e gjithë gurëve e rrënëjëve,
e madhe dhe e ashpër si kjo tokë.

Nën çantën e shpinës e nën kraharor
është dora e motrave
dhe pemët e vendlindjes tek tundin degët e gjelbra.

Po shkojmë!

Prapa mbetet vendlindja,
malet që ngjajnë aq shumë me fytyrën e baballarëve,
fushat që kanë diçka të afërt me nënrat,

pemët, lulet dhe rrugët
që na kujtojnë të dashurat dhe motrat...
Ndërsa përpara ngrihen përsëri male të reja,
fusha, rrugë dhe njerëz të tjerë
që kanë të gjithë
fytyrën madhështore të Atdheut.

TRYEZA JONË

Aroma e bukës,
era e njelmët e djersës së babait
dhe puhiza e lehtë e frymëmarrjes së nënës
vijnë çdo ditë
sa herë që ulem në tryezë
e futen në frymëmarrjen time thellë.

I ndiej
kur tyta e pushkës në poligon
djeg dhe mban erë barut,
i ndiej
kur në themelet e një vepre
duart më plasariten nga gurët.
E di,

lodhemi për lumturinë,
lodhemi
që zemrat të na çlodhen në gjëzimin e qindra fitoreve

Dhe ja, para meje
shfaqen gjithë tryezat e popullit
në tryezën e madhe të Atdheut, —
brenda trupit tim gjaku derdhet me forcë.

Askush nuk do të pështyjë mbi tryezën tonë,
mbi bukën,
mbi djersën,
mbi dashurinë.

Askush nuk do të mund ta përbysë
tryezën e madhe të lumturisë.

S K E L A T E R E J A

Ngjitemi mbi skelat e reja
me nga një petale vjollcash në buzë
dhe gërqelen rënë mbi jakë të kominosheve
si një gonxhe të bardhë
që e çeli mëngjesi...

Ngjitemi —
sikur ecim drejt hapësirave të kaltra
ndërsa nën qerpikë
na zgjohet më shkëlqimin e fortë
qyteti i ardhshëm.

Ngjitemi, ngjitemi...
Kova e llaçit dhe gurët
bëhen më të lehtë në duart tona.
Këtë peshë
e ngrënë edhe duart e atyre që do të vijnë në këtë
qytet.

Ngjitemi mbi skelat e reja
sikur ecim drejt hapësirave të kaltra
me peshën e gëzimit të mijëra njerëzve
hedhur mbi supe...

Ballsh 1975.

V A J Z A T

Ju do t'i keni takuar diku këto vajza,
këto vajza të mira
me flokë të mbledhur nën kasketa,
që gjer vonë qepur në lartësinë mes dritash
ngrihen mbi legjenda,
dhe firmën e tyre
lënë kudo ballë veprash.

Do t'i keni shtërnguar patjetër
duart e plasaritura nga dimri dhe hekuri
ku dashuria më e qëndrueshme është
dhe çiltërsia ngroh si një ditë prilli.

Dhe vijnë ato pa bujë midis nesh
duke i lënë kohës kujtimet e mëdha të punës,
këngëve frymëmarrjen e vet
dhe Shqipërisë fëmijë.

DRITARET E QYTETIT TIM

Dritaret e qytetit tim shikojnë nga lindja,
nga lindja bie dhe kantieri i madh
në djepin e kësaj lugine që përkund puna.

Nesër puntorët do ta zhveshin nga skelat
dhe nga ky djep
do të ngrihet uzina me shtat të hekurt,
përkundur për një pesëvjeçar rresht.

Këto dritare panë gjithçka,
që nga guri i parë i themelit
e gjer në gurin e fundit.
Dëgjuan ninullat e para,
ninullat e sirenave e të zhurmave të hekurta
që i kënduan rritjes së saj.

Dhe mbetën
 dritaret e qytetit tim
si qindra sy optimistë
duke reflektuar në brendësi të tyre
kantierin e madh dhe qiellin.

TE KJO RRUGË

Punëtorët i għħendën gurët mbi shpinën e sa
dhe asfaltin hodhën.

Elektriċistët i vunë neonet mbi shtyllat e gjata
dhe lulishtarët
lule e pemë mbollën.

Edhe fēmijët e prunë poteren e tyre
pa tē cilēn kjo rrugë s'do tē kishte kuptim.
Edhe ne, e dashur,
asħtu thjesht siċ del një lule,
dashurinē tònë celém
dhe kësaj rruge ia lamë si më tē bukurin kujtim.

INXHINIERIT TË NDËRTIMIT

Dhjetor.

Qielli ngarkuar me shira,
rrugët gjithë baltë.

Pardesy e re ngeli e pavesur te garderoba,
këpucët janë pluhurosur nën krevat,
te jastëku të pambaruar dy libra,
në tavolinë boja e stilografit është tharë.

S'kemi kohë për rroba të mira,
rrobat e mira të dielave dhe ditëve të festave ua kemi
lënë.

Betoni s'pret.

Si mund të lëmë pa ngritur themelet e hapura
kur në piketat dhe paralelet e tyre
pritet të lindë një qytet.

Ballsh 1974.

* *

Më pëlqen shumë kjo barakë kantieri
mbuluar me pupulit,
kjo tavolinë me dhoga ahu

ku shkruaj poezi,
kjo vazo lulesh prapa dritares,
ku erërat grinden me motorët e kamionave.
Shokët flenë

me gëzimin e ëndrrave nën qerpikët e lodhur
dhe fjalët e ditës,
si fragmente poezish, përsëriten natën.

Më pëlqen,
M'u bë e domosdoshme kjo jetë
ku çdo ditë mësoj diçka të re
e përditë ripërtërihem
me frymëmarrje të gjerë mendimesh e motivesh

Ballsh 1975.

V J O L L C A

M o t r ē s

Vjollca, Vjollca!
Thirra unë te dritarja e hapur
dhe prita
si atëherë të nderje gërshetat jashtë,
të rendnim në kopsht,
një grusht xixëllonja në flokë të të hidhja
e gjer në lodhje të rendnim me zogjtë...

Ti kishe ikur rrugëve të jetës
duke marrë me vete mallin tim
gërshetat e bukur

dhe dashurinë.

Në krahët e lumturisë qeshje me zë prej gruaje...
Është e vërtetë,
ti një ditë do të ikje
po s'duhet ta harrosh dritaren tonë, Vjollca,
dritaren nga shikonim botën,
as kopshtin e vogël

që tashmë është bërë kopsht i madh.

Në rrugën tonë prej trëndafilash

kalon një hekurudhë,

në sheshin tonë të blertë

janë themelet e një uzine,

te pisha e vjetër në kodër,

ku çdo mëngjes çonim buzëqeshjen tonë,

është ngritur një monument.

Qyteti ynë tashmë është bërë me më shumë rrugë,

me më shumë njerëz, më i bukur,

ashtu siç e ngrinim ne në arkitekturën e imagjinatës

sonë . . .

A K U A R E L

Dielli i pasdites zgjat hijet e kantierit jugor
gjer mbi malet
e në fytyrat tona krijon reflekse purpuror
para se nga ne të ndahet.

Ngjyrat dridhen, fëshfërijnë nëpër freskinë e pasdites,
konturet përflaken.

E si mund të mendosh këtu ardhjen e natës
kur pas pak qindra diej reflektorësh do të ndizen!...

Ballsh 1975.

SHIU I PRANVERËS

Na zuri ky shi i pranverës në trase,
ky shi i papritur gjithë shushurimë,
po ne gazmorrë qëndronim atje,
flokët e lagur njomnin shaminë.

Pantallonat ngritur mbanim mbi gju
ndërsa shiu i dendur s'reshtte;
kishim me vete dashurinë këtu
dhe peisazhin e bukur që queshte.

Brenda vetes forcat ne ndjemë..
Si hapësirat e gjera të qiellit
pranverës çdo ngjyrë i rrëmbyem
dhe shiun dhe lulet dhe diellin.

GJITHMONË MBETET DIÇKA

Gjithmonë mbetet diçka pas nesh,
gjurmë të lodhjes me fytyrën e lumturisë.

Nga një grumbull zhavorri e gurësh
mbin një qytet.

Mbi egërsinë e një lumi
ngrihet dritë.

Mbi ashpërsinë e një mali
nxjerrim bukë.

E mbi vitet që ikin
lëmë zërin tonë...

SIRENA E PARË NË MALLAKASTËR

Kish net që ish vjedhur gjumi nga sytë tanë,
kish net që prisnim diçka...

Diçka të bukur, më tronditëse se gëzimi.

Unë gjithë ditën rendja me kazmë buzë trasesë
e gjithë natën mbi vargje lodhesha.

Kisha ditë e net të tëra që prisja buçimën e saj.

Sirena e parë. —

Sytë e tim eti u lëngështuan,
u bënë më të butë, më të thellë u bënë,
u përpëlitën, u kalamendën si djep i një ëndrrë.

Sytë e mi u lagën — sirena e parë.

Mbi shallin e një aksionisteje
diellin të ngrihej pashë
dhe tej në horizont lokomotivën tek vinte.

MOLLA E FËMIJËRISË

Mollë e vjetër
me shenjat e litarëve të lëkundësve në degët e çelura,
si erdhe gjer këtu në kantierin e largët,
në dritaren e kësaj barake populiti,
me thirrjet miturake,
me puthjet dhe buzëqeshjet fëminore,
mbetur te kokrrat e kuqe!...

Si erdhe gjer këtu në kantierin e largët
e në xhamat e dritares me pranverën troket!...

Ballsh 1974.

NJË NATË SHIU

Shi.

Nëpër rrugët e kantierit shiu kthehet në rrëke.
Mbi reflektorët,
mbi zjarrin e saldatriçeve,
shiu shndërrohet në një masë të paformë avulli.

Shiu breron mbi turnin e tretë.

Pas pak agimi i bardhë
do të zbulojë në trupin vigan të uzinës
edhe një kullë më shumë
ngritur brenda një turni.

Shi.

Në fytyrat e shokëve breron gëzimi,
në fytyrën e mëngjesit breron urimi...

Ballsh 1974.

NATA E FUNDIT E KËTIJ VITI

Eshtë nata e fundit e këtij viti.
Në barakat e drunjta ka zhurmë.
Hapja dhe mbyllja e nxituar e dyerive,
urimet,
aroma e portokajve në xhepat e shokëve,
këmishat e lara
dhe tavolinat e shtruara
na e bëjnë të ngrohtë këtë natë funddhjetori.

Eshtë nata e fundit e këtij viti.
Në gjoksin e montatorit të ri
është mbështetur kitara
me një tufë motivesh mbi tela
si një tufë shpendësh
ardhur në stinën e kantiereve...

Eshtë nata e fundit e këtij viti.
Në duart e shokëve të mi

rri gota e dollisë për gurët e parë të themeleve të
nesërim
si dhuratë e duarve tonë
gjithë të dashurve
dhe gjithë Shqipërisë
në këtë vit të Ri.

Ballsh 1974.

P A M B U K V J E L È S E T

Kur ngjyrat e vjeshtës bëhen gjithmonë e më të verdha
dhe si yje ndizen zjarret e fushës,
vajzat e fermës,

me përparsët plot pambuk,
lëvizin si bohçe të mëdha
duke i shtuar edhe një ngjyrë më shumë stinës.

Fërfërijnë duart e pambukvjelëseve
dhe nën qerpikët e tyre
çelin gjithë ngjyrat e basmave.

C'ngjyrë do të zgjedhin vallë pér fustanin e nusërisë,
ç'basmë do të presin këmishë pér dhëndërinë e djemve?

Fërfërin pambuku në duart e vajzave.
Mes kësaj bardhësie,
ku zemra e tyre është më e bardha,
kalon era e vjeshtës
si një këngë e rrëmbyer dasme...

D I T A E F È M I J È V E

Ja, mami një bluzë të bardhë paska sjellë
me një yll/ tē kuq qëndisur...

Fluturojnë nga foleja zogjtë
e cicërimat i sjellin te dritarja.

Lepurushët kanë ardhur në kopshë
e kërcejnë si në përrallëz.

Edhe qershia paska ulur më shumë degëzat —
buzët e fëmijëve

tē kuqe si dy qershia...

DITËN E NJË SHTATORIT

Enkeljanës 6 vjeçare

Eshtë i pafund numri i luleve,
emrat e tyre të panumërt janë
ashtu si emrat e gjithë fëmijëve
që sot ulen në bangën e parë.

Ngjyrat e luleve janë të shumta
si ëndrrat tuaja, o gjashtëvjeçarë;
aty ku fillon të hedhë hapin A-ja,
krahët tuaj fluturim kanë marrë.

Eshtë ngritja juaj e dytë në këmbë
rrugë e gërmave që të çon në jetë,
që këtej janë nisur të gjithë, nga kjo bangë, —
të gjithë — heronj dhe njerëz të thjeshtë...

P A S Q Y R I M

Saranda, si vajzë gazmore e posazgjuar,
para pasqyrës së dridhshme të Jonit rri
me agrumet e shpleksura tek ia krehin erërat,
me kaktuset e gjelbra si qerpik
dhe diellin
ngrohtësishët si buzëqeshje tek i skuq.

Kështu e pashë këtë mëngjes Sarandën
në pasqyrën e kthjellët të detit.
Portin e vogël
me anijet ngarkuar me grurë e agrume,
pallatet e reja
tek shtohen si çerdhet e pranverës,
rrugët e saj
si damarë që në vend të gjakut kanë diell...
Pashë shkallët e tarracave gjatë brigjeve,
shkallët
që të ngjisnin nga thellësitë e këtij pasqyrimi
gjer lart në vështrimin e maleve...

V I E T N A M

Isha fëmijë atëherë
kur nëna kokën më mbante midis duarsh,
përrallën e përgjakshme të paqes dhe luftës tregonte,
përrallën e gjallë,
që ishte e vërtetë atje larg
në vendin Vietnam.

Vonë kuptova
ajo nuk kish qenë ndonjëherë përrallë.

Ai popull
njoju dhembje e plagë të përbindshme.

Sajgoni digjej
qytet pa gjumë, pa natë dhe mëngjes.

Kish në botë qytete moderne
që gogësinin drogë e gjak,
Sajgoni — napalm.

Tokio, si shtrigë,
krihej në pasqyrën prej flake të qielit vietnamez,
Moska puthej me Nju-Jorkun
e nga ajo puthje
lindnin krimë të reja,
tradhti e luftra dështake.

Ishin ata
që dogjën e rrënuan Trojen
dy mijë e ca vjet më pare.

Ata, të ringjallur,
sot me Pragën
tallen si me Trojën.

Ata,
lirinë e Afrikës duan ta mbajnë si një negre të lidhur,
ëndrrat,
lulet dhe gjakun e popujve.

Por sot,
në lindjen vietnameze,
ata panë perëndimin e tyre
dhe honin e varrit që gjëmon.

Tani në Vietnam është mëngjes.
Vietnam
të rënëve u ngre qytetin e mermertë të pavdekësisë.

Tani në Vietnam është mëngjes.

Vietnami

hap tokën për të mbjellë bukën e paqes,
ringre oxhaqet,
hap rrugë, lidh Veriun me Jugun —
dhe plagët e tij,
si qindra sy të kuq,
vështrojnë mbi gjithë tokën
duke dënuar gjithë vrasësit.

VAJZA QË QENDISTE YJE

P o e m ē

Heroinës Liri Gero

Ç'shkëlqim ka ylli që rritet
pranë e më pranë zemrës sate!...
Në diellin e ditëve tonë,
motra ime,
mbetën të pesë cepat e tij.

Ç'ngjyrë kanë dy sytë e tu,
motra ime,
ç'dritë kanë!...
Në thellësi të yjeve
është ngjyra e tyre.

Si të ta ripërtëri buzëqeshjen vajzërore...

Buzëqeshjen

çelur mbi një flamur të madh

tek qëndisje yje,

me dy gërshtat e gjatë

larë në diell...

Në agun e lindjes, motra ime,

ka mbetur bukuria e asaj buzëqeshje...

Si të ta ringjall zërin e asaj këngë

që ti,

më bukur nga të gjitha këngët,

dije ta këndoje...

Në shpirtin e të gjitha këngëve

rron zëri yt,

motra ime me emrin Liri.

* * *

*

Të shoh

ulur në pragun e gjelbër të pranverës,

pranverës

me rrënjet e shkulura të luleve

dhe pjalmin

shkundur mbi plagët e të rënëve,

tek qëndis

cepat e një ylli

mbi këmishën gjak të Shqipërisë.

Po ç'ish kjo pajë, motër,
kjo pajë me yje e flamur?...

Ti pajën e dasmës së madhe qëndisje.
Më një mijë e nëntëqind e dyzet e katër
Atdheu
nuse do të kishte lirinë,
nuse të rrallë
veshur me një pëlhirë të kuqe...



Të shoh
në prehrin e Myzeqesë ulur
Himnin e Flamurit
duke kënduar lehtë-lehtë.

Këtë këngë
ti dije ta këndoje më bukur nga të gjitha këngët.
Brenda dashurisë sate
afshi i saj
lulet e ëndrrave hapte,
lulet e shumëngjyrta
në kopshtin e madh të popullit...
Ndërsa jashtë portave,
në rrugë,

atë këngë e ndiqnin këmishëzintë.
Foletë e yjeve kërkonin,
shpendët e bardhë të trakteve,
që fluturonin guximshëm
nga strehëzat komuniste..
Por komunistë,

yje

dhe këngë
ish mbushur gjithë Myzeqeja,
komunistë,

yje

dhe këngë
ish mbushur gjithë Shqipëria.



Në gjoksin e dhembjes sate
rrinte Myzeqeja
e zverdhur,
me dridhjet e etheve
ndanë kënetave brengëshumë
duke lyer plagët
me baltën e saj të zezë.

Nëna
me opingat e lopës

dhe fustanin e grisur, —
gjithmonë me fëmijë të uritur
kaq pranë sofrës më të madhe të Atdheut.

* * *

Që Shqipëria
të mos e kish tokën
për dhëmbët e Musolinit dhe Hitlerit
dhe qiellin
për ëndrrat e tyre të mos e kish,
që rrugët
të ishin për hapat e jetës sonë,
që fëmijët
të dinin të buzëqeshnin,
që çurga e ujit
nga gurra të rridhte
për etjen tonë,
që dielli
të digjte për ne
dhe çdo grimcë dheu
të thërrmohej,
të lagej,
gjelbërimin të rriste për ne —
ti bridhje kudo pragjeve të popullit
me traktet e Partisë

fshchur nën bluzën e leshtë,
zërin e saj
duke e ngritur kûshtrim.

Ujërat e egërsuar të të gjithë lumenjve të botës
mblidheshin në një oqean të pafund revolte.

Ti ishe ndanë Semanit,
e pagjumë
si dallgët,
motra ime gjashtëmbëdhjetëvjeçarc,
dhe e ndieje dhembjen e derdhjes së gjakut nëpër
botë.

* * *

*

Atë ditë
shtëpinë e le pa fshirë,
lulet pa i ujitur
dhe një cep të yllit
pa e mbaruar.

Ike,
cepin e pestë
në mal për ta endur...

Ike
e mitur në rrugën e luftës,
motër, ike...

Mbi ballin tënd
ylli duket më i madhi,
mbi supin tënd
pushka dukej më e gjata,
mbi dëborë
gjurmët e tua
 ishin më të voglat
dhe në kolonë
ti ishe e para,
partizania e vogël,
 partizania e madhe...

* * *

Si mund të harrojmë
gjurmët e këmbëve të zbathura,
pambarim tek ecnin drejt lirisë,
si mund të harrojmë?

Ato gjurmë na kujtojnë gjithçka —
misërniken
që më katersh në kupë të gjurit ndanim,
me një kokërr qepë kalonim dy ditë;
pagurin e luftës që sa herë e kemi puthur,
nga buzët e tij
njëri-tjetrin puthnim;

kapotën e vetme të çetës,
në të ngrohtësia e trupit të të gjithë shokëve kish
mbetur
dhe dashuria e të gjithëve, motër;
supin e shokut,
jastëkun e dremitjeve tonë
ku lodhjen mbështetnim
e dremisnim pak,
aq pak
sa për të ëndërruar këto ditë,
për të parë në atë ëndërrim të shpejtë,
ndërprerë nga krismat,
të ardhmen...

* * *

*

I dimë vendet ku morëm plagët...
Edhe sot,
si vetëtima, nëpër mish
na lëvizin ciflat e predhave.

I dimë shtigjet ku u përqafuam me fitoret,
i dimë vendet ku hodhëm në qiell të luftës
një breshëri lamtumire
për ata
që si një pjesë e shpirtit tonë u ndanë...
I dimë... e nuk harrojmë.

* *

Nën qerpikët e tu, motër,
nuk lodroi drita shkëlqenjëse e dashurisë, —
në ninëzat e kaltëruara
u drodh vetëm flaka e qyteteve në djegie e si-
për ...

Jo,

nuk ish koha për lule,
për puthje e ditë ledhatare.

Zemra

ishte e zënë me rrahje të fuqishme.
Ti jetove çaste të madhërishme
kur flamuri i Atdheut
njomej në gjak
e gjak pikonte mbi Shqipërinë.

* *

*

Ka mbetur tek të gjithë ajo natë beteje —
Lushnja me shtëpi të djegura,
vjeshta e dytë

flokëndezur
me të rënët
si piketa të kuqe
nga do të kalonte liria.

Askush s'e ka harruar atë natë tectori,
trupin tënd lidhur pas tankut.

Për një çast u drodh rrezja e diellit
me mornica të dridhshme tmerri... .

O, mizoria më shumë ç'mund të bënte!

Asgjë nuk mundi ta zbërthente heshtjen tënde,
asgjë,
dashurinë për nënën e nënave—Partinë,
nuk mundi nga gjoksi ta ndante
asgjë.

Kush vallë do të mundte
rrënjet e yllit pesëcepësh të shkulte?!. . .



Askush s'e ka harruar atë natë tectori.

Çetinën e trupit tënd

roniste zjarri,
gjithçka të bukur në atë trup digje.

O!

Borova u ringjall!...
U ringjallën shëmtimet e gjithë krimeve
nga thellësitë e kohrave,

që nga Kartagjena
e gjer te ajo natë.

O!

Ish e madhe dhembja,
shtërngimi pa kufi i gjoksit...
Na shtrydhej zemra,
pikonte lotë
mbi pishtarin e trupit tënd.
motra ime, Liri.

* * *

Si mund të digjeshin vallë ajo zemër
dhe ato duar të shkathëta
që sa e sa herë ngrohe
në tytën e nxeh të pushkës...

Ato duar
kanë mbetur të dridhshme
mbi rubinët e plagëve tonë
ashtu tek na i lidhje qetë nëpër llogore.

I shoh ato duar
tek lëvizin dashurisht
mbi palët e flamurit...

E shoh erën e ngrohtë të jugës
tek luan me gërshetat e tua
dhe diellin
me shkëlqime nën qerpikët e përzhitur ...
Shoh profilin tënd, motër,
tek buzëqesh
brenda të pesë cepave të yllit ...

POEMA E DITËVE TË PARA

Prindëve tē mi

Ish ende dimër,
kish baltë e borë në udhë,
hiri i luftës, që posa kish heshtur,
ngrihej pirgje-pirgje mbi tokë.

Nëpër këmbë
na ngatërroheshin ende predha e helmeta,
krismat
ende na vetonin nëpër mendime,
në trup
ende rrobat e luftës kishim...

Sa ishim ndarë me të rënët —
fjalët e ndarjes na kumbonin të gjalla.
Trupi i tyre

na ish ende i ngrohtë,
plagët
na digjnin ende duart dhe zemrat.

* *

Ish ende dimër
e maleve
retë udhëtonin me shtërngata ngarkuar.
Në shpirt na mugullonte shpresë e mirë,
në kraharor
përplaseshin krahët e kuq të një kënge.

Ndër sy
na shkëlqenin ëndrrat
me arkitekturën e bukur të këtyre ditëve.
Dhe nëdeje
gjaku i nxeh të i betejës së re
me forcë na rridhte.

Pranvera
çelte mbi gjermadhat e dimrit të vjetër,
lulet
buisnin mbi varret e posambuluar.
Kish hyrë pranvera, bir,
pranvera e një kohe tjetër,
e kohës së madhe të Partisë.

* * *

Jo, ti s'di ç'janë triskat,
s'i njeh...
Sot ti ulesh në një tryezë të begatë,
por mos harro
se dikur
Partia,
si nënë e mirë,
bukën dhe kripën na ndante
shkruar me gramë në një copë kartë...

Mos harro
gishtat tanë të pamësuar
që A-në shkruanin të dërsitur mbi letër.
Mos harro
çatitë e para të shtëpive tonë.
Nga këto çati do të lindnin qytete
me pragje të ndritura.

Pragjet!
Që në ditët e Reformës Agrare
Enver Hoxhën pritën
e këto fusha
që atëherë e kanë plot prehrin,
minierat i kanë plot thellësitë

e koha jonë,
mbi djepin e dhjetëra kantiereve,
dhjetëra vepra lind.

Po, kështu e nisëm, bir:
me pak barut,
me pak bukë
me shumë halle dhe këngë pa fund.

P A S Q Y R A E L È N D È S

Hyrja e pranverës	3
Poezia e nënës	4
Fëmijëria	6
Dy fjalë për babanë	8
Deshë të thosha diçka	10
Djersa	12
Kur u dashurua një shok	13
Në vend të epilogut	14
Urë e Qabesë	15
Vlora	18
Vallja e trimërisë	21
Peshkatari i thinjur i ligjenit të Shkodrës	23
Karrocierët	25
Atë mbrëmje nëntori	26
Fëmijët e veprës së re	27
Drita e Drinit	29
Rapsodi i dritës	31
5 Maj	32
Invalidi i luftës	33
Nisja e ushtarëve të rinj	34
Tryeza jonë	36
Skelat e reja	38
Vajzat	40
Dritaret e qytetit tim	41

Te kjo rrugë	42
Inxhinierit të ndërtimit	43
Më pëlqen shumë kjo barakë kantieri	44
Vjollca	45
Akuarel	47
Shiu i pranverës	48
Gjithmonë mbetet diçka	49
Sirena e parë në Mallakastër	50
Molla e fëmijërisë	51
Një natë shiu	52
Nata e fundit e këtij viti	53
Pambukvjetëset	55
Dita e fëmijëve	56
Ditën e një shtatorit	57
Pasqyrim	58
Vietnam	59
Vajza që qëndiste yje	62
Poema e ditëve të para	74